



REPUBLIKA E SHqipëRIE
MINISTRIA E ARSIMIT
SPORTIT DHE RINISË

AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

PROGRAMI I ZHVILLIMIT PROFESIONAL PËR MARRJEN E KATEGORIVE TË KUALIFIKIMIT NGA MËSUESIT E GJUHËS SHQIPE DHE TË LETËRSISË, 2021

1. HYRJE

Profesioni i mësuesit kërkon përkushtim, përgjegjshmëri dhe standarde të larta në punë dhe në sjellje. Mësuesit veprojnë me ndershmëri dhe integritet, përdorin dijet dhe aftësitë e tyre në punën e përditshme, krijojnë marrëdhënie pozitive profesionale, si dhe bashkëpunojnë me prindërit në interesin më të mirë të nxënësve. Gjithashtu, ata përditësojnë vazhdimisht njohuritë e tyre për të mundësuar shërbim cilësor arsimor në përputhje me kërkesat e kohës.

Programi i zhvillimit profesional për marrjen e kategorive të kualifikimit nga mësuesit e gjuhës shqipe dhe të letërsisë është hartuar nga një grup pune që është ngritur në Agjencinë e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP). Programi synon t'u vijë në ndihmë Drejtorive Rajonale të Arsimit Parauniversitar (DRAP-ve) dhe Zyrave Vendore të Arsimit Parauniversitar (ZVAP-ve), si dhe të gjithë mësuesve të gjuhës shqipe dhe të letërsisë për t'u përgatitur për testimin e kombëtar për marrjen e kategorive të kualifikimit.

Programi iu përmbahet kërkesave që MASR ka vendosur për mësuesit që do të marrin pjesë në procesin e kualifikimit. Ai është hartuar duke mbajtur parasysh se fushat kryesore, në të cilat testohen njohuritë dhe aftësitë e mësuesve janë:

- dokumentet zyrtare¹, të cilat kanë të bëjnë me veprimtaritë mësimore dhe edukative të mësuesve;
- programet mësimore të gjuhës shqipe dhe të letërsisë (klasat VI-XII);
- aspektet e pedagogjisë dhe të metodologjisë në mësimdhënie-nxënie në përgjithësi, si dhe të lëndës së gjuhës shqipe dhe të letërsisë, në veçanti;
- aspektet e etikës dhe të komunikimit;

¹ Është fjala për të gjitha dokumentet ligjore, urdhëresat dhe udhëzimet e MASR- së që zbatohen në shkollë, duke u përqendruar në ato të viteve të fundit.

- aspektet e drejtshkrimit të gjuhës shqipe;
- përmbajtja shkencore e gjuhës shqipe dhe e letërsisë, sipas programeve mësimore përkatëse.

2. QËLLIMET E PROGRAMIT

Qëllimet e programit të zhvillimit profesional të mësuesve për marrjen e kategorive të kualifikimit janë:

- të ofrojë një program të detyruar për mësuesit që këtë vit do të marrin kategoritë e kualifikimit, në mënyrë që ata të përgatiten për të përballuar me sukses kërkesat që ka testimi kombëtar;
- të ofrojë një program orientues për t'u ardhur në ndihmë të gjithë mësuesve të gjuhës shqipe dhe të letërsisë në arsimin parauniversitar për të realizuar veprimtaritë kualifikuese, si dhe DRAP- ve dhe ZVAP-ve për të organizuar zhvillimin profesional të mësuesve. Në këtë aspekt programi mund të plotësohet nga DRAP-et dhe ZVAP-të, sipas kushteve dhe mundësive konkrete.

Programi synon që mësuesi:

- të njohë dhe të zbatojë legjislacionin arsimor e në mënyrë të veçantë risitë më të fundit të reformës arsimore;
- të zotërojë kompetencat, bazuar në standardet profesionale të mësuesit, për të ndikuar drejtpërdrejt në efektivitetin e procesit mësimor për një mësimdhënie të suksesshme;
- të demonstrojë aftësitë në fushën pedagogjike për përzgjedhjen e modeleve për organizimin e klasës, për shtjellimin e koncepteve, për nxitjen e diskutimeve, për përdorimin e teknikave të vlerësimit të nxënësve etj.;
- të tregojë përgjegjshmëri në njohjen e koncepteve bazë dhe ligjësive shkencore të lëndës/ve, si dhe në zbatimin e tyre në praktikë, në përputhje me specifikat e moshës së nxënësve dhe të klasës ku jep mësim;
- të demonstrojë zbatimin e rregullave të etikës dhe të komunikimit në punën e tij në shkollë;
- të zotërojë zbatimin e rregullave drejtshkrimore të gjuhës shqipe gjatë procesit të mësimdhënie -nxënies;
- të përdorë aftësitë e TIK-ut, si një nga risitë më të fundit në mësimdhënien bashkëkohore.

3. PËRMBAJTJA E PROGRAMIT

Programi është strukturuar sipas fushave kryesore të zhvillimit profesional, të përmendura më sipër. Për të qenë lehtësisht i përdorshëm, programi është paraqitur sipas një formati të caktuar. Për secilën fushë përcaktohen:

- kompetencat profesionale, si dhe rezultatet e pritshme për realizimin e këtyre kompetencave;
- literatura përkatëse rekomanduese në funksion të përvetësimit të kompetencave të fushës.

Përshkallëzimi i njohurive dhe i aftësive profesionale, të cilat lidhen me kompetencat e secilës fushë të testimit, do ta ndihmojnë mësuesin që të identifikojë çështjet në të cilat duhet të përqendrohet.

Përmbajtja e programit sipas fushave

FUSHA : DOKUMENTET ZYRTARE	
Kompetenca: Zbatimi me përgjegjshmëri dhe me korrektesë i kërkesave të legjislacionit dhe të dokumentacionit shkollor.	Literatura e rekomanduar
Rezultatet e pritshme Mësuesi: <ul style="list-style-type: none"> - njeh dhe zbaton ligjin “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”; - zbaton udhëzimet dhe rregulloret për hartimin dhe zbatimin e kurrikulës shkollore; - zbaton udhëzimet dhe rregulloret për personelin e shkollës; - demonstroi zbatimin konkret të udhëzimeve të MASR- së në funksion të përmirësimit të procesit të mësimdhënie-nxënies; - zbaton etikën profesionale të mësuesit; - respekton detyrat, të drejtat dhe liritë e tij; - respekton detyrat, të drejtat dhe liritë e 	<ul style="list-style-type: none"> - Ligji nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. - Udhëzuesi për fillimin e vitit shkollor 2020-2021 në sistemin arsimor parauniversitar. - Shtojca 1 “Për disa plotësime në udhëzuesin e fillimit të vitit shkollor 2020 -2021”. - Rregullore e funksionimit të institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë, miratuar me Urdhër nr.31, datë 28.01.2020 - Udhëzimi nr. 30, datë 12.09.2018 “Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar”. - Udhëzimi nr. 1, datë 20.01.2017 “Për

<p>nxënësit;</p> <ul style="list-style-type: none"> - zbaton rregulloret dhe udhëzimet për zhvillimin profesional të mësuesit. 	<p>funksionimin e sistemit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional të punonjësve arsimorë”.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Udhëzimi nr. 34, datë 11.09.2015 “Për vlerësimin e nxënësve për kurrikulën me kompetenca, në arsimin bazë”. - Udhëzimi nr. 14, datë 28.07.2016 “Për vlerësimin e nxënësve në arsimin e mesëm të lartë”. - Urdhri nr. 6, datë 10.01.2018 “Për zbatimin e nismës “Tri lëndë në gjashtë orë””. - Urdhri nr. 46, datë 24.07.2020 “Për standardet profesionale të formimit të përgjithshëm dhe të formimit lëndor të mësuesve në sistemin arsimor parauniversitar”.
---	--

FUSHA: PROGRAMET LËNDORE	
<p>Kompetenca: Zbatimi në mënyrë efektive i programeve të gjuhës shqipe dhe letërsisë në shkollë.</p>	<p>Literatura e rekomanduar</p>
<p>Rezultatet e pritshme</p> <p>Mësuesi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - njeh dhe zbaton programin duke respektuar të gjitha kërkesat dhe rubrikat e tij; - përshtat programin lëndor në përputhje me nxënësit dhe me veçoritë e mjedisit, në të cilin jep mësim; - përdor me efikasitet, në dobi të prirjeve bashkëkohore, fleksibilitetin e zbatimit të programit; - gjen ose harton materiale plotësuese 	<ul style="list-style-type: none"> - Korniza kurrikulare, 2014. - Kurrikula bërthamë AMU, klasat VI-IX, 2014. - Kurrikula bërthamë AML, klasat X-XII, 2016. - Programet lëndore të bazuara në kompetenca, për klasat 6-9, lënda “Gjuhë shqipe”. - Programet lëndore të bazuara në kompetenca, për klasat 10-12, lëndët “Gjuhë shqipe”, “Letërsi” dhe “Letërsi me

<p>kurrikulare që ndihmojnë në përvetësimin e koncepteve dhe të aftësive të përcaktuara në program;</p> <ul style="list-style-type: none"> - gjen ose harton materiale plotësuese kurrikulare që pasurojnë formimin e nxënësve, si dhe nxitin mendimin e pavarur dhe kritik të tyre; - njeh dhe zbaton koherencën vertikale të programeve të gjuhës shqipe dhe të letërsisë; - harton rezultate të nxëni për tema mësimore ose grupe temash, që janë në përputhje me programin; - përzgjedh metodat, teknikat dhe mjetet mësimore të nevojshme për të realizuar përmbushjen e rezultateve të të nxënit; - siguron informacion që demonstroi lidhjen e gjuhës me letërsinë, me shkencat e tjera dhe me jetën reale. 	<p>zgjedhje”.</p>
---	-------------------

FUSHA: ASPEKTE TË PEDAGOGJISË, METODOLOGJISË DHE PËRDORIMIT TË TIK -UT NË MËSIMDHËNIE-NXËNIE	
<p>Kompetenca 1: Zotërimi i njohurive pedagogjike specifike të nevojshme dhe të mjaftueshme për mësimdhënien e gjuhës shqipe dhe të letërsisë.</p>	<p>Literatura e rekomanduar</p>
<p>Rezultatet e pritshme Mësuesi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - demonstroi përkushtim, motivim dhe përgjegjësi gjatë punës së tij; - përshtat punën e tij me zhvillimin njohës, social dhe emocional të nxënësve; 	<ul style="list-style-type: none"> - Korniza e vlerësimit të nxënësit, MAS, 23.07.2015. - Udhëzuesi i zhvillimit të kurrikulës në arsimin e mesëm të ulët, 2017. - Udhëzuesi i zhvillimit të kurrikulës në gjimnaz, 2016.

<ul style="list-style-type: none"> - përdor metoda, teknika dhe strategji që synojnë gjithëpërfshirjen e nxënësve në procesin e të nxënës; - identifikon nxënësit me nevoja të veçanta dhe planifikon punën afatshkurtër dhe afatgjatë me këta nxënës; - demonstroi qëndrim pozitiv ndaj gjuhës dhe letërsisë; - demonstroi respekt, besim dhe objektivitet me nxënësit; - edukon të nxënësit dashurinë dhe kërkueshmërinë ndaj gjuhës shqipe dhe letërsisë; - motivon nxënësit duke e konsideruar motivimin, si një nga çelësat e progresit të tyre; - krijon klimë të përshtatshme, motivuese dhe të kënaqshme për nxënësit; - bashkëpunon me prindërit për përmirësimin e progresit të nxënësit. 	<ul style="list-style-type: none"> - Udhëzues për kurrikulën me zgjedhje në gjimnaz, 2018. - Udhëzuesi për zhvillimin e lëndës së gjuhës shqipe në arsimin e mesëm të ulët, 2018. - Udhëzuesi për zhvillimin e gjuhës shqipe dhe të letërsisë në arsimin e mesëm të lartë, 2018. - Udhëzuesi për vlerësimin e nxënësve gjatë mësimin në distancë dhe për mbylljen e vitit shkollor 2019-2020.
<p>Kompetenca 2: Përdorimi i metodave dhe i strategjive efektive në mësimdhënien e gjuhës shqipe dhe të letërsisë.</p>	<p>Literatura e rekomanduar</p>
<p>Rezultatet e pritshme</p> <p>Mësuesi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - përzgjedh metodat dhe teknikat e përshtatshme për arritjen e rezultateve të të nxënës; - përdor metoda e teknika që nxisin mendimin kritik e krijues të nxënësve; - planifikon dhe zhvillon orë mësimore duke u bazuar në mësimdhënien me në qendër nxënësin; 	<ul style="list-style-type: none"> - Udhëzuesi i zhvillimit të kurrikulës në arsimin e mesëm të ulët, 2017. - Udhëzuesi i zhvillimit të kurrikulës në gjimnaz 2016. - Nivelet e arritjes (arsimi bazë dhe arsimi i mesëm), 2016. - Udhëzues për kurrikulën me zgjedhje në gjimnaz, 2018. - Vlerësimi i nxënësit në arsimin e mesëm të ulët dhe në arsimin e mesëm të lartë. (<i>Material shpjegues në ndihmë të shkollave</i>),

<ul style="list-style-type: none"> - përdor metoda e teknika që ndikojnë në ndërtimin dhe zhvillimin e kompetencave kyç dhe kompetencave lëndore; - njeh dhe zbaton gjatë procesit të të nxënit lloje të ndryshme të vlerësimit; - vlerëson nxënësit duke u bazuar në nivelet e arritjeve; - përdor teknika dhe evidenca të ndryshme për vlerësimin e nxënësit; - zhvillon me nxënësi teste që zbatojnë parimet e hartimit dhe të pikëzimit të një testi. 	<p>shtator 2019.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Udhëzuesi për zhvillimin e lëndës së gjuhës shqipe në arsimin e mesëm të ulët, 2018. - Udhëzuesi për zhvillimin e gjuhës shqipe dhe të letërsisë në arsimin e mesëm të lartë, 2018. - Modele testesh për arsimin parauniversitar (<i>Teste të hartuara nga mësuesit</i>), profili “Gjuhë shqipe dhe letërsi”. - Udhëzuesi për vlerësimin e nxënësve gjatë mësimit në distancë dhe për mbylljen e vitit shkollor 2019-2020. - Udhëzuesi për fillimin e vitit shkollor 2020-2021 në sistemin arsimor parauniversitar.
<p>Kompetenca 3: Përdorimi i teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit për të rritur cilësinë e mësimdhënies/nxënies së gjuhës shqipe dhe të letërsisë.</p>	<p>Literatura e rekomanduar</p>
<p>Rezultatet e pritshme</p> <p>Mësuesi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - prezanton materiale mësimore duke përdorur programe të përshtatshme si: Power Point, Excel, Word; - nxit nxënësit të bëjnë prezantime gjatë orës së mësimit duke përdorur TIK-un; - gjen dhe përdor materiale nga website për të pasuruar dhe për të përmirësuar mësimdhënie-nxënien; - përfshin nxënësit në projekte lëndore, të cilat ndërthuren me kërkime, gjetje dhe përdorime materialesh nga burime të ndryshme në internet. 	<ul style="list-style-type: none"> - Materiale në ndihmë të mësuesit të gjuhës shqipe dhe të letërsisë për përdorimin e TIK-ut në mësimdhënie -nxënie.

FUSHA: ASPEKTE TË ETIKËS DHE TË KOMUNIKIMIT

Kompetenca: Zbatimi i rregullave të etikës dhe të komunikimit si elemente të domosdoshme në të gjithë punën e mësuesit.	Literatura e rekomanduar
Rezultatet e pritshme Mësuesi: <ul style="list-style-type: none">- njeh rregullat e etikës dhe të sjelljes që duhen respektuar në marrëdhënie me drejtuesit e institucionit arsimor, kolegët, nxënësit, prindërit dhe komunitetin;- zbaton rregullat e etikës dhe të sjelljes në marrëdhënie me drejtuesit, stafin pedagogjik, nxënësit, prindërit dhe komunitetin, gjatë punës së tij brenda dhe jashtë institucionit arsimor.	<ul style="list-style-type: none">- Kodi i etikës së mësuesve.- Urdhri nr. 46, datë 24.07.2020 “Për standardet profesionale të formimit të përgjithshëm dhe të formimit lëndor të mësuesve në sistemin arsimor parauniversitar”.

FUSHA: ASPEKTE TË DREJTSHKRIMIT TË GJUHËS SHQIPE

Kompetenca: Zbatimi i rregullave drejtshkrimore të gjuhës shqipe.	Literatura e rekomanduar
Rezultatet e pritshme Mësuesi: <ul style="list-style-type: none">- njeh dhe zbaton rregullat e drejtshkrimit të gjuhës shqipe;- vlerëson rëndësinë e përdorimit të gjuhës standarde në të gjitha veprimtaritë dhe punët e tij.	<ul style="list-style-type: none">- Drejtshkrimi i gjuhës shqipe.

FUSHA: PËRMBAJTJA SHKENCORE E LËNDËS

Kompetenca: Respektimi i rigorozitetit shkencor në mësimdhënien e lëndës së gjuhës shqipe dhe të letërsisë.	Literatura e rekomanduar
--	---------------------------------

<p>Rezultatet e pritshme</p> <p>Mësuesi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - analizon dhe jep gjykimet e tij për letërsinë shqipe e botërore, për periudhat dhe drejtimet letrare, si dhe për shkrimtarët përfaqësues dhe krijimtarinë e tyre letrare; - kupton, interpreton, analizon dhe vlerëson tekste e fragmente të ndryshme letrare dhe jo letrare; - shkruan ese me tematika që lidhen me çështje të ndryshme arsimore; - analizon dhe vlerëson tiparet e stilit dhe të gjuhës në një tekst ose fragment; - kryen analiza të sakta nga fusha e sistemit gjuhësor të shqipes; - respekton rregullat gramatikore, drejtshkrimore dhe të pikësimit. 	<ul style="list-style-type: none"> - Tekste të gjuhës shqipe, të letërsisë dhe të letërsisë me zgjedhje, për nxënësin dhe për mësuesin, si dhe materiale të tjera burimore që mbulojnë përmbajtjen lëndore për klasat 6-9 për arsimin e mesëm të ulët, si dhe për klasat 10 - 12 për arsimin e mesëm të lartë.
--	---